

Intervistë me znj. Courtney Bickert, Drejtore e Organizatës Holandeze për Zhvillim (SNV) për Shqipërinë dhe Drejtore Rajonale për Ballkanin.

## SI TË LIDHENI ME HOLANDËN

**P**rej 14 vjetësh Organizata Holandeze për Zhvillim (SNV), e financuar kryesisht nga Ministria e Jashtme Holandeze (rreth 3 milion euro në vit për gjithë Ballkanin), ka dhënë ndihmesë në ngritjen e kapaciteteve të organizatave vendase në vendin tonë dhe prej 2 vjetësh e ka shtrirë këtë veprimtari edhe në rajonin e Ballkanit. E përqendruar në sektorin e turizmit, bujqësisë dhe pylltarisë, SNV-ja në Shqipëri ka ndihmuar në ngritjen e kapaciteteve të Shoqatave të Përdoruesve të Pyjeve në nivel vendor, rajonal dhe kombëtar, ka bashkëpunuar me qeverisjen vendore për planifikimin e zhvillimit rural dhe ekonomik, si dhe ka mbështetur politikat kombëtare të orientuara në zhvillimin rural dhe bujqësor. Kjo është bërë e mundur edhe me shtrirjen e SNV-së me 4 zyra në Fier, Korçë, Tiranë dhe Dibër.

**Slogani juaj thotë se mbështesni njerëzit që marrin përgjegjësi dhe nisma. Cilët sektorë të ekonomisë po mbështesni dhe çfarë ndikimi ekonomik ka ndihma juaj në komunitetet me të cilat punoni?**

Ne mbështesim njerëzit që marrin përgjegjësi dhe nisma dhe e bëjmë sepse mendojmë se çdo lloj zhvillimi, përfshirë dhe atë ekonomik, duhet të vijë nga vetë njerëzit. Dëshira për të bërë ndryshime, për të zhvilluar aftësitë që janë të nevojshme për t'u rritur dhe për të patur më shumë mundësi për të gjeneruar të ardhura, duhet të vijë nga individët dhe organizatat në terren. Duke mbështetur nismat që vijnë nga vetë organizatat, besojmë se kontributi ynë është më i qëndrueshëm dhe më efektiv. Në fushat ku punojmë kemi parë rezultate premtuese në zhvillimin ekonomik, që lidhen me disa nga iniciativat tona. Për shembull, së bashku me Organizatën Botërore të Turizmit u bëmë partnerë të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në draftimin e ligjit të ri të plotë për turizmin. Ky ligj kaloi në kuvend më 14 maj të këtij viti dhe u

miratua. Sipas një eksperti ndërkombëtar për turizmin, z. Xhon Douns (John Downes), nëse ligji zbatohet siç duhet, rreth 10 mijë familje fshatare në zonat e largëta të vendit do të rrisin të ardhurat si pasojë e zhvillimit të turizmit natyror ose atij kulturor. Ne mendojmë se ky është një zhvillim i rëndësishëm, ndaj po e ndjekim procesin duke bashkëpunuar me PNUD në përgatitjen e akteve nënligjore të nevojshme për zbatimin e ligjit. Shembulli tjetër i ndikimit tonë (përmes shërbimeve këshillimore) gjendet në studimin e Bankës Botërore rreth projektit në sektorin e pyjeve që u zbatua në vitet 1997-2001. Studimi tregon se të ardhurat e familjeve gjatë periudhës kur u zbatua projekti u rritën me 30% dhe afro 30-43% e kësaj rritjeje ishte e lidhur me sektorin e pyjeve. Pra, treguesit e punës të cilën ne bëjmë me prodhuesit, ka dhënë ndihmesë në ndryshimin e gjendjes ekonomike të tyre. Kemi mbështetur gjithashtu takimet me grupet e interesit në nivel bashkie për të siguruar pjesëmarrje dhe reagime për politikën kombëtare të bujqësisë, e cila pritet të rrisë vlerën e punës për fermer në Shqipëri nga 3600 euro që është sot, në 7500 euro në vitet që vijnë.

**Zhvillimi ekonomik i vendit tonë është i lidhur ngushtë me integrimin në BE përmes liberalizimit të regjimit tregtar. A punon SNV-ja në ngushtimin e hendekut të prodhuesve shqiptarë drejt standardeve europiane?**



Patjetër, po punojmë me grupet e prodhuesve në bujqësi dhe pylltari për forcimin si të organizatave që ata kanë krijuar, ashtu dhe të aftësive të tyre për të përmbushur standardet e BE-së në mënyrë që të jenë konkurrues. Një nga qëllimet tona kryesore është që prodhuesit vendas të mund të hyjnë në tregje të reja të brendshme dhe të jashtme, pasi me afrimin e anëtarësimit në Bashkimin Europian, e vetmja mënyrë për të qenë konkurrues është që prodhuesit shqiptarë të jenë të aftë



të përmbushin standardet. Vitin e kaluar lehtësuam pjesëmarrjen e një grupi prodhuesish të vajit të ullit në Fier në një panair ndërkombëtar në Italinë e Jugut. Ne mbajmë marrëdhënie të ngushta me agjencitë e certifikimit si ALCEBO, Alb-Inspect etj. Pra, nëse grupet e prodhuesve kërkojnë ndihmë për çështje certifikimi në lidhje me standardet e BE-së, ne mund të lehtësojmë shumë mirë lidhjet që u nevojiten për të marrë këtë lloj mbështetjeje. Është një nga përparësitë e punës sonë.

**Cilat janë planet tuaja për të ardhmen e aftërit?**

SNV-ja do të vazhdojë të përqendrohet në fushat e turizmit, bujqësisë dhe pylltarisë me qëllimin kryesor shtimin e mundësive për të rritur të ardhurat, prodhimin dhe punësimin. Ne synojmë gjithashtu të sigurojmë përmirësimin e qeverisjes si përmes politikave të zhvillimit rural, ashtu dhe zbatimit të këtyre politikave. Shpresojmë që të realizojmë atë që në strategjinë tonë e quajmë "lokalizim të BE-së", që është sjellja e përfitimave të anëtarësimit në BE më afër prodhuesve ruralë dhe komuniteteve rurale. Ne duam t'i ndihmojmë ata që të mund të përfitojnë. SNV punon aktualisht edhe në tre shtete të tjera ballkanike: në Maqedoni, Mal të Zi e Bosnjë Hercegovinë, dhe synon të vazhdojë në këtë linjë. Një nga përparësitë për vitet e ardhshme është të vazhdojmë shtimin e nismave ndërkufitare në rajon, sepse ato janë thelbësore dhe me përfitim të ndërsjellë për zhvillim ekonomik të vendeve pjesëmarrëse në to. ■



... (44%) vitin e kaluar e zunë importet e ushqimeve të gatshme dhe pijeve të ndryshme. Në eksporte automjetet dhe pajisjet mekanike dhe elektrike kanë zënë gjatë vitit të kaluar rreth 80% të

eksporteve, përkatësisht 45% dhe 36%. Në nënprodukte, importet e pijeve në total nga Holanda kanë pësuar rënie nga 3.3 milion dollarë në vitin 2001 në vetëm 0.6 milion dollarë gjatë vitit të kaluar.

Megjithatë, importet e pijeve jo-alkoolike kanë ardhur në rritje dhe sipas të dhënave të ACIT, gjatë vitit të kaluar përbëjnë gati totalin e pijeve të importuara nga Holanda me rreth 0.54 milion dollarë. ■